REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:028459
Datë: 24.09.2021
Numri i dokumentit: 02209195

PKR.nr.40/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes trupit gjykues në përbërje prej gjyqtarit Aziz Shaqiri – kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve : Islam Thaçi dhe Menderez Behluli – anëtarë të trupit gjykues, , me sekretaren juridike Kadrije Zymberi , në lëndën penale kundër të akuzuarve : Ç. L. nga ... dhe B... K... nga fshati S.. Komuna e F....., tani me vendbanim në ....., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2.të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr. .../2021 të datës 22 shkurt të vitit 2021, të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Shaban Spahiu, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 07 shtator të vitit 2021 nxjerr dhe në prani të prokurorit të shtetit si dhe të të akuzuarve, në të njëjtën ditë, publikisht shpall ndërsa e përpilon më 20 shtator të vitit 2021 këtë,

A K T GJ Y K I M

I. Të akuzuarit :

1. Ç.. L... nga i ati L.... dhe e ëma A.... – me mbiemër të vajzërisë M...., i lindur më ..... në ....., ku edhe e ka vendbanimin me adresë rruga “ ..... “ banesa përballë Spitalit, kati ...-të, dera e ..... e banesës afër shkallëve, posedues i telefonit mobil me SIM kartele ....., posedues i lejes së njoftimit me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, student i vitit II-të në ..... – me seli në ..... – Shkencat Politike, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, i është tërëhequr vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën me shkrim ose verbalisht personalisht në rast të ndërrimit eventual të vendbanimit ose vendqëndrimit të tij, nën kërcënim të pasojave ligjore,

2021:033699

2. B.. K... nga i ati R..... dhe e ëma M..., me mbiemër të vajzërisë H...., i lindur më ..... të vitit ..... në fshatin ....., tani me vendbanim në F....., me adresë rruga " ..... " p.n. posedues i lejes së njoftimit me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e me\sme- asistent i marketingut, punon në NNP " B..... " me seli në F....., me gjendje të mesme ekonomik, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, i është tërëhequr vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën me shkrim ose verbalisht personalisht në rast të ndërrimit eventual të vendbanimit ose vendqëndrimit të tij, nën kërcënim të pasojave ligjore,

J a n ë f a j t o r ë

sepse më datën 06.05 të vitit 2020, rreth orës 12,55 , në Agjencionin për transferimin e parave " R... " me seli tek Stacioni i autobusve në Gjilan, me qëllim të përfitimit material, me dashje në bashkëveprim kanë vënë në qarkullim para të falsifikuara të metalta edhe atë 12 copë në apoena prej nga 2 (dy) Eur, duke e ditur paraprakisht se të njëjtat janë të falsifikuara, në atë mënyrë që paraprakisht në Ferizaj kishin ardhur me veturën e të akuzuarit Ç..... dhe pasiqë kishin ndal veturën para Agjencionit në fjalë në Gjilan, i akuzuari Ç.... ia kishte dhënë të akuzuarit B..... 25 copë monedha metalike në apoena prej nga 2 Euro kurse i pandehuri B..... kishte hyrë në Agjencionin e tillë dhe kishte kërkuar nga zyrtari i Agjencionit F..... B..... këmbimin – ndërrimin e këtyre parave të metalta me para të letrës mirëpo zyrtari i këtij agjencioni pasiqë kishte dyshuar se të njëjtat mund të ishin të falsifikuara e kishte pyetur fillimisht të akuzuarin B..... për prejardhjen e tyre e pastaj is kishte kthyer 26 Euro të metalta, kurse të tjerat ia kishte ndalur kurse i akuzuari B..... kishte dal nga Agjencioni kinse për t'u kthyer prapë por pasiqë për këtë dyshim në falsifikimin e tyre e kishte njoftuar të akuzuarin tjetër, të njëjtit largohen me të shpejt nga aty, mirëpo ma vonë të njëjtit janë identifikuar përmes kamerave të sigurisë së këtioj Agjencioni,

-ashtu që me veprimet e tyre të njëjtit në bashkëveprim si bashkekzekutorë kanë kryer veprën penale **falsifikimi i parasë** nga neni 296 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-s,

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, 71 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3. dhe nenit 72 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të KPRK-s, si dhe nenit 365 lidhur me nenin 326 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s), të akuzuarit në fjalë

I GJ Y K O N

Secilin prej tyre me <u>dënime me burgim në kohëzgjatje prej nga nëntëdhjetë (90) ditë,</u> të cilat dënime pas shpalljes, me pëlqimin shprehimisht të dhënë nga të akuzuarit në fjalë, në kuptim të nenit 44 të KPRK-s, edhe atë :

2021:033699

a)Të akuzuarit ÇLIRIM LUMA dënimi me burgim I ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) Euro, të cilin duhet ta përmbush në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

mirëpo, nëse eventualisht i akuzuari Çlirim Luma nuk dëshiron ose nuk mund ta përmbush në tërësi apo pjesërisht dënimin me gjobë, në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s, i njëjti

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë ditëve , ose në mënyrë përpjestimore me dënimin e mbetur me gjobë të pa paguar, duke ju llogaritur 20 Euro me një ditë burgim, e të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ftesës për mbajtjen e dënimit me burgim, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm të këtij dënimi, kurse

b) Të akuzuarit B..K.... dënimi me burgim I ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) Euro, të cilin duhet ta përmbush në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

mirëpo, nëse eventualisht i akuzuari B.... K..... nuk dëshiron ose nuk mund ta përmbush në tërësi apo pjesërisht dënimin me gjobë, në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s, i njëjti

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë ditëve , ose në mënyrë përpjestimore me dënimin e mbetur me gjobë të pa paguar, duke ju llogaritur 20 Euro me një ditë burgim, e të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ftesës për mbajtjen e dënimit me burgim, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm të këtij dënimi.

II.Në kuptim të nenit 296 paragrafi 6 të KPRK-s monedhat metalike të falsifikuara edhe atë 12 copë në apoena prej nga dy Euro, e në shumë të përgjithshme prej 24 Eurove, të cilat duhet të shkatërrohen nga ana e komisionit të formuar nga ana e kryetarit të kësaj gjykate, duke u konstatuar me procesverbal.

III. DETYROHEN i akuzuari Ç.... L. që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkatësisht paushallin gjyqësor në shumën prej **tetëdhjetë (80) Euro**, kurse **i akuzuari B. K..** shumën **prej pesëdhjetë (50) Eurove ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave secili prej tyre veç e veç shumën prej nga pesëdhjetë (50) Euro**, të gjitha në afat prej **pesëmbëdhjetë (15) ditëve**, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

a) Hyrje në arsyetim

Organi i ndjekjes penale kundër të akuzuarve në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se të njëjtit në bashkëkryerje si bashekzekutorë kanë kryer veprën penale lëndore, sipas përshkrimit faktik dhe kualifikimit juridik në aktakuzën lëndore por edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

2021:033699

Për veprën penale nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK-s parashihet dënimi me burgim prej **një deri në tetë vjet.**

kurse sipas paragrafit 5 të nenit 296 shprehimisht parashihet konfiskimi i parave të falsifikuara.

Gjykata pa shtyerje ka caktuar shqyrtimin gjyqësor duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë sipas aktakuzës lëndore.

Meqë sipas nenit 57 të KPP-s mbrojtja profesionale e të akuzuarve për veprën penale lëndore nuk është e detyrueshme, pas udhëzimit nga kryetari i trupit gjykues se në kuptim të nenit 58 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të KPP-s, meqë të akuzuarit shprehimisht kanë deklaruar se janë të aftë për t'u mbrojtur lidhur me veprën penale e cila ju vihet në ngarkesë, e është vlerësuar se interesat e drejtësisë nuk kërkojnë që të akuzuarve të ju caktohet mbrojtës profesional sipas detyrës zyrtare, kryetari i trupit gjykues ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me çështjen lëndore duke jua mundësuar të akuzuarve që të mbrohen secili personalisht , por duke u kujdesur që të njëjtëve mos të ju shkilet asnjë e drejtë procedurale.

Kryetari i trupit gjykues pasiqë ka konstatuar se i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit F. Z. B. sipas konstatimit të dorëzuesit gjendet jashtë vendit në I.... në adresë të panjohur sipas familjarëve të tij, e në anën tjetër financiarisht nuk është i dëmtuar i njëjti meqë nuk ka bërë këmbimin e parave të vërteta me ato të falsifikuara që ia kanë ofruar të akuzuarit në fjalë përkatësisht njëri prej tyre, e në anën tjetër ka konstatuar se ka prova të mjaftueshme të cilat i janë bashkëngjitur aktit akuzues andaj edhe me këtë rast janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e seancës së shqyrtimit gjyqësor, pastaj në kuptim të nenit 323 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-s fillimisht i ka ftuar të akuzuarit që ta përcjellin me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor, i ka udhëzuar se kanë mundësi të paraqesin fakte në dobi të tyre, që t'i shtrojnë pyetje të bashkëakuzuarit, dëshmitarve, ekspertëve eventual, të bëjnë vërejtje dhe të japin shpjegime rreth deklarimeve të tyre. Pastaj të njëjtit i udhëzon se kanë të drejtë të mos deklarohen lidhur me çështjen e tyre penale ose që të mos përgjigjen në asnjë pyetje të parashtruar, se nëse vendosin që të deklarohen lidhur me çështjen penale, nuk janë të detyruar ta inkriminojnë vetveten ose të afërmit e tyre, e as ta pranojnë fajësinë, e sa i përket mbrojtjes profesionale të njëjtit janë udhëzuar fillimisht se mund të mbrohen personalisht meqë në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me çështje penale për të cilën mbrojtja profesionale është e detyrueshme, ose se mund të mbrohen nëpërmjet ndihmës juridike të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tyre ose të njëjtëve të ju caktohet mbrjtës profesional sipas detyrës zyrtare, nëse plotësohen kushtet ligjore nga neni 58 të KPP-s. Lidhur me të drejtën në mbrojtës kryetari i trupit gjykues ka dhënë arsyetimin përkatës më lart.
Njëherit të njëjtit mund ta kundërshtojnë aktakuzën dhe pranueshmërin e provave në të cilën mbështet akti akuzues përkitazi me akuzën lëndore.

Njëherit u konstatua se prokurori i shtetit ka plotësuar detyrimin ligjor sa i përket dorëzimit të provave në të cilat mbështet akti akuzues të pandehurve në fjalë.

Prokurori i shtetit pasi që lexoj aktakuzën dhe deklaroj se ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e fajësisë së këtij të pandehuri për veprën penale lëndore, gjykata u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën e lexuar duke u mbrojtur në mënyrë aktive, e pastaj kryetari i trupit gjykues jua ofroj mundësinë të akuzurve për t'u deklaruar lidhur fajësinë apo pafajësinë e tyre.

2021:033699

Secili prej të akuzuarve veç e veç me vetëdije të plotë u deklaruan se e pranojnë fajësinë për veprën penale e cila ju vihet në ngarkesë.

Trupi gjykues pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve lidhur me veprën penale e cila ju vihet në ngarkesë me aktin akuzues, vlerësoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 lidhur me nenin 326 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPP-s edhe atë : se të akuzuarit me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve në fjalë është bërë vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë, pas njoftimit nga kryetari i trupit gjykues se si të akuzuar nuk jeni të detyruar që ta pranoni fajësinë lidhur me veprën penale lëndore, u vlerësua se pranimi i fajësisë nga ane të akuzuarve mbështet në faktet e çështjes penale që rrjedhin nga provat që i përmban aktakuza lëndore, duke përfshirë edhe deklarimin e të akuzuarve dhe se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të çartë ligjore por as gabime faktike që ndërlidhen me çështjen penale dhe të akuzuarit në fjalë,
andaj edhe me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në fjalë, për kryerjen e veprës penale e cila ju vihet në ngarkesë si bashkekzekutorë, duke vazhduar pastaj shqyrtimin gjyqësor me fjalët përfundimtare të palëve:

Prokurori i shtetit ka deklaruar se : si përfaqësues i aktakuzës në fjalë ka potencuar se mbetet në trësi pranë aktakuzës kudnrë të akuzuarve në fjalë, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 296 çparagrafi 2 të KPRK-s.
Gjendja faktike në këtë çështje penalo-juridike është vërtetuar nga provat e siguruara në hetuesi, deklarimi i të pandehurve në shqyrtimin e sotë gjyqësor me rastin e pranimit të veprës penle dhe përgjegjësisë penale për këtë vepër. Mbi këtë bazë është fokusuar vetëm në rrethanat me ndikim në nxjerrjen e vendimit të drejtë dhe ligjor , ashtu që si rrethana rënduese faktin e viteve të fundit veprat e tilla penale janë në rritje e sipër jo vetëm për regjionin e Kosovës, por gadi në të gjitha Regjionet e Republikës së Kosovës, ndërsa si rrethanë lehtësuese faktin se të akuzuarit
Në shqyrtimin e sotëm kanë pranuar fajësinë lidhur me veprën penale, duke u penduar për kryerjen e saj. Mbi këtë bazë gjykatës i ka propozuar që të akuzuarve të ju shqiptoj një dënim meritor sipas Kodit Penal, me propozim që të konfiskohen parat e falsifikuara në shumën e përgjithshme prej 25,00Euro edhe atë 12 copë nga 2 Euro.

I akuzuari Ç.. L. gjatë fjaës përfundimtare ka deklaruar : se me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndore, se është penduar për veprimin e pamatur të tij , duke i premtuar gjykatës seriozisht se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, se asnjëherë më parë nuk ka qenë i gjykuar për kurrfarë vepre penale dhe as që zhvillohet ndonjë procedurë penale kundër tij, se me punën e tij personale kontribuon në mirëqenien e familjes së tij së bashku me babin e tij, se është student i vitit të ... në Univerzum – shkencat politike, rrethana këto të mjaftueshme për shqiptimin e një dënimi sa më të butë.

I akuzuari B. K.. gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar, se është pendua shumë për veprimin e pamatur të tij, gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëritë veprime të tilla penale, se me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka pranuar fajësinë, se është mbajtës i vetëm i familjes dhe punën e tij personale, se asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe se as që zhvillohet ndonjë procedurë penale kundër tij, rrethana këto të mjaftueshme që gjykata t'i shqiptoj një dënim të arsyeshëm.

2021:033699

Trupi gjykues ka vlerësuar provat e pa administruara por të bashkëngjitura aktit akuzues lëndor edhe atë si ato personale ashtu edhe ato materiale :
-deklaratën e të akuzuarve sidomos deklarimin e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë pa hezitim bile duke ndier keqardhje për veprimet e pamatura të tyre, deklaratën e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit F. B. të dhënë me detale lidhur me rrjedhjen e ngjarjen penale konkrete e cila përputhet në tërësi me përmbajtjen e video incizimit të nxjerr nga kamerat e sigurisë së Agjencinë për transferimin e parave RIO me seli në Gjilan – tek Stacioni i autobusëve të këtij qyteti, raportit të oficerit policor me numër të rastit policor 2020-CA-..... të datës 06.05 2020, formularit të dëshmisë, raportin e ekzaminimit të monedhave metalike në apoena prej nga 2 Euro me shumë të përgjithshme prej 24 Eurove, sipas të cilit është konstatuar se monedhat në dëshminë #1 janë plotësisht të falsifikuara, foto dokumentacionit dhe akteve tjera në shkresa të lëndës,
duke ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 248 paragrafi 1. të KPP-s për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve pasiqë :

-nga provat e bashkëngjitura aktit akuzues vlerësohet se pranimi i fajit nga ana e të akuzuarve në fjalë gjatë shqyrtimit gjyqësor është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe mbështetet në faktet relevante të çështjes penale që përmban aktakuza lëndore, duke **vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë** se të njëjtit në bashkëveprim si bashkekzekutorë kanë kryer veprën penale lëndore sipas përshkrimit faktik dhe kualifikimit juridik të saj e të cilën e përmban akti akuzues lëndor,

-se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale lëndore, e në anën tjetër ky pranim është bërë vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë nga ana e të akuzuarve në fjalë pa i shtyer dhe kërcënuar askush,
- në anën tjetër akti akuzues lëndor nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore si në pikëpamje të përshkrimit faktik të çështjes penale ashtu edhe të kualifikimit juridik të saj e as gabime faktike të cilat kishin me ndikuar përmbajtësish në ligjshmërinë e aktit akuzues lëndor.

b) Përfundimet e nxjerra nga gjykata dhe përcaktimi për dënimin përkatës si dhe vendosja për kërkesën pasurore juridike

Gjykata pas vlerësimit të provave të bashkëngjitura aktit akuzues lëndor ashtu të paadministruara ka ardhur në përfundim se të akuzuarit në fjalë në bashkëveprim si bashkekzekutorë kanë kryer veprën penale lëndore nga neni 296 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-s pasiqë të njëjtit e kanë ditur se monedhat metalike në apoena prej nga 2 Eurove me shumë të përgjithshme prej 24 Eurove janë të faklsifikuara dhe të njëjtat i kanë lëshuar në qarkullim edhe atë të njëjtat I akuzuari i parë ia ka dhënë të akuzuarit të dytë për t'i ndërruar në Agjencionin në fjalë në Gjilan ku edhe ishin shkuar me veturën e të akuzuarit të parë, me qëllim që t'i marrin nga i njëjti, monedhat e vërteta, mirëpo zyrtari i këtij agjencioni tani si dëshmitar ka dyshuar se të njëjtat janë të falsifikuara, e në momentin kur e ka pyetur të akuzuarin e dytë për prejardhjen e tyre, i njëjti ka dal nga ajgencioni i tillë dhe pasiqë e ka njoftuar të akuzuarin e parë me veturën e tij janë larguar, mirëpo përmes kamerave të sigurisë së këtij agjencioni më vonë janë identifikuar si kryes të veprës penle lëndore. Me vet faktin që të akuzuarit e kanë ditur se monedhat e tilla metalike janë të falsifikuara dhe të njëjtat I kanë lëshuar në qarkullim, të njëjtit në bashkëveprim si bashkekzekutorë janë future në zonën penale, duke qenë përgjejgës për veprën penale nga neni 296 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-s.

2021:033699

Gjykata me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të pandehurve ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-s edhe atë:

pranimin e fajësisë, premtimin e sinqert se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, pendimin e thellë për veprimin e pamatur të tyre, se asnjëherë më parë nuk kanë qenë të gjykuar për vepër penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme e as që zhvillohet kundër tyre ndonjë procedurë penale, gjendjen ekonomike jo të mirë në rrethana të posaçme për shkak të pandemisë – covid 19 në territorin e Republikës së Kosovës duke përshirë edhe përmasat botërore, moshën e tyre relativisht të re, derisa i akuzuari i parë është student i rregullt i vitit të dytë në Univerzitet – shkencat politike, i akuzuari i dytë është mbajtës i vetëm i familjes me të ardhurat që i siguron në kushtet ekonomike të vendit tonë në kohë pandemie nga një biznes privat, por edhe shkallën e ultë të pasojës juridike të shkaktuar duke i vënë në qarkullim monedhat e metalta të falsifikuara në shumën prej vetëm 24 Euro, pa e dëmtuar efektivisht në aspektin financiar palën e dëmtuar, meqë e njëjta ka konstatuar se parat e ofruara për këmbim nga të akuzuarit janë të falsifikuara, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar në bazë të provave të lartcekura edhe pse të pa administruara e të cilat gjenden në shkresa të lëndës të bashkangjitura aktakuzës lëndore si dhe rrethanat lehtësuese të cekura më lartë të cilat ashtu të sulmuara paraqesin rrethana veçanërisht lehtësuese, gjykata është e bindur se edhe me një dënim të zbutur me burgim në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 lidhur me nenin 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-s në kohëzgjatje prej tre muajve, i cili me pëlqimin e palëve është zëvendësuar me dënim me gjobë në kuptim të nenit 44 paragrafi 1 të KPRK-s, gjykata ka vlerësuar se mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimeve të tilla të shqiptuara si ndaj të akuzuarve ashtu edhe ndaj qytetareve potencial, duke i rehabilituar të njëjtit por edhe duke i parandaluar që në të ardhmen mos të kryejnë vepra tjera me të cilat i dëmtojnë të mirat juridike të kësaj natyre apo të ngjashme, edhe pse në rastin konkret zyrtari i agjencionit nuk ia ka këmbyer monedhat e tilla prej 24 Euro me monedha të vërteta në formë të kartëmonedhave, gjë që në rastin konkret realisht edhe nuk është dëmtuar pala e dëmtuar, e për këtë shkak as që ka parashtruar ndonjë kërkesë pasurore juridike për kompensimin e dëmit eventual.

Gjykata, në kuptim të nenit 44 të KPRK-s ka aprovuar propozimin e të akuzuarve dhe ka vendosur që dënimin me burgim prej 90 ditëve t'ia zëvendësoj me dënim me gjobë sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje të plotë se edhe me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-s duke i parandaluar të akuzuarit që në të ardhmen mos të kryej vepra penale me natyrë të njëjtë apo të ngjashme por edhe duke e rehabilituar të akuzuarit për t'iu kthyer jetës normale si qytetar i ndershëm që jeton me djersën e tzre, por edhe tek qytetarët potencial duke i parandaluar nga sjelljet e tyre kriminale të kësaj natyre ose të ngjashme.
Njëherit gjykata konsideron se dënimet e shqiptuar shpreh gjykim shoqëror të të akuzuarve për veprën penale lëndore, me synim që tek të të njëjtit të ngrit moralin dhe forcoj detyrimin për respektimin e ligjit penal me të cilin mbrohen nga dëmtimi apo rrezikimi të mirat relevante juridike të qytetarëve por edhe të shoqërisë si tërësi.
Në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë duke u njoftuar shprehimisht të akuzuarit në fjalë se nëse eventualisht nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë në tërësi apo pjesërisht, pasiqë i akuzuari i parë është student i rregullt kurse i akuzuari i dytë mbajtës i vetëm i familjes me të ardhura të ulta që i realizon në kohë pandemie në një biznes privat, atëherë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s të

2021:033699

njëjtit do të zëvendësohen me dënime gjegjëse me burgim, duke ju llogaritur çdo 20 Euro të barabarta me një ditë burgim.

c) Konfiskimi, shpenzimet e procedurës penale, taksa për kompensimin e viktimave të krimit

Gjykata në kuptim të nenit 296 paragrafi 5 të KPRK-s ka bërë konfiskimi e monedhave metalike të falsifikuara në shumë prej 24 Eurove, të cilat do të shkatërrohen nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate.
Lidhur me shpenzimet e procedurës penale – paushallin gjyqësor është vendosur në kuptim të nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPP-s, ndërsa as i përket taksës është vendosur në kuptim të nenit 39 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Ligji nr.05/L-036.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.40 /2021 më dt.07 shtator të vitit 2021

Sekretarja juridike, **Kryetari i trupit gjykues,**
Kadrije Zymberi Aziz Shaqiri d.v

<u>Udhëzim për mjetin juridik:</u> Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

2021:033699